



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 21.07.2020, me fillim në ora 10.00.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.
Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Kryetarit të Komunës, për periudhën gjashtë mujore janar – qershor 2020;
3. Shqyrtimi i Raportit nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për periudhën gjashtë mujore janar qershor 2020;
4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pëlqimit për këmbim të pronës publike komunale P – 04381-0;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatshkurtër;
7. Raport nga DKA-ja rreth përfundimit të vitit mësimor 2019/2020;
8. Informatë nga DSHPS-ja, për periudhën gjashtë mujore janar – qershor -2020;
9. Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit;
10. Informatë nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm;
11. Të ndryshme.

Kryesuesi – A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo e vë në votim rendin e ditës:
Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush ndonjë vërejtje apo të shtojë dikush diçka rreth procesverbalit. Nëse jo atëherë e vë në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar e KPF-së, konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar. Kalojmë në pikën e radhës:

Të nderuar nëse jeni të pajtimit pasi nënkryetari është pak i zanë do kalojmë në pikën e tretë pastaj do e shqyrtojmë raportin e punës së kryetari

3. Shqyrtimi i Raportit nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për periudhën gjashtë mujore janar qershor 2020;

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar po e paraqes në pika të shkurta para juve Raportin Financiar 6 mujorë të drejtorisë për financa dhe buxhet, pasi që e keni pasur si material raportin. Në këtë raporte janë të përfshirë kategoritë ekonomike të pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale, në këtë raport nuk janë të përfshirë të hyrat nga gjykatat. Të nderuar të hyrat për këtë 6 mujorë janë për 124,000.00 € më pak nëse e krahasojmë me 6 mujorin viti të kaluar, dhe ty hyrat e rregullta të realizuara për këtë 6 mujorë janë rreth 404,602.34 €. Për më shumë nëse keni ndonjë pyetje këtu jam për të ju përgjigjur.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar ky raporte është një raporte shumë i qartë, janë të cekura në mënyrë tabelara të gjitha të dhënat sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve për këtë 6 mujor. E kuptojmë se ky 6 mujorë pse nuk ka pasur të hyra, por kishte me qenë mirë që në 6 mujorin e dytë të planifikohen të hyrat më mirë, në faqe nr. 3,4 dhe 5 kërkojë sqarim rreth shifrave të prezantuara ku janë të prezantuara të hyrat në baza mujore, pastaj këtu janë të cekura edhe gjërat nga trafiku dhe gjykatat, po ashtu në faqe 5 te kodi i tatimit në pronë jemi duke parë që ka pasur ngecje në të hyra, prandaj në 6 mujorin e dytë duhet të punohet më shumë që këtë të hyra të kompensohen. Po ashtu dua një sqarim sa i përket shpenzimeve sipas kategorive ekonomike që janë paraqitur në mënyrë grafike në këtë raport.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari drejtor a keni ndonjë plan B për sanimin e këtyre të hyrave në këtë 6 mujorin e parë, pra ka plan B për stimulim të qytetarëve për të kryer obligimet e tyre ndaj komunës.

Afrim Limani – Të nderuar inkasomi i dobët i ty hyrave në komunë është si rrjedhojë e gjendjes së krijuar nga pandemia, qytetarët nuk kanë mundur të dalin dhe të kryejnë obligimet e tyre, ne pothuajse në muajin mars dhe prill nuk kemi pasur fare të hyra, por shpresojmë se në 6 mujorin e dytë do të kemi të hyra më shumë. I nderuari doktor sa i përket të hyrave nga gjërat dhe gjykatat neve na kanë ardhur pasi të ju kemi dërguar materialin për mbledhje të KPF-së, por për mbledhje të kuvendit do ta keni raportin e kompletuar me të gjitha të dhënat që mungojnë sot. Ndërsa a kemi ne një plan B sa i përket inkasimit të të hyrave, po ne kemi një plan B por këtë plan nuk do r zbulojë tani do e lë ka muaji nëntor.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e zhvilluar, konstatoj se Raportit nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për periudhën gjashtë mujore janar qershor 2020, kalon për kuvend. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Kryetarit të Komunës, për periudhën gjashtë mujore janar – qershor 2020.

Fatmir Iska - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar ky raporte i ka të cekura të gjitha aktivitetet që janë bërë nga ekzekutivi për periudhën 6 mujore të viti 2020, ju e keni pasur këtë raport, nuk dua të ju humbas kohë tani të ju prezantoj faqe për faqe, por nëse keni ndonjë pyetje jam këtu për të ju përgjigjur.

Kryesuesi – Ju faleminderit i nderuari nënkryetar, a dëshiron dikush të merë fjalën sa i përket raportit të punës së kryetarit për 6 mujorin e parë të vitit 2020, nëse jo atëherë konstatoj se edhe ky raporte kalon për mbledhje të kuvendit. kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë.

Afrim Oruqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtori prezantoi para anëtarëve të KPF-së pikën e katërt të rendit të ditës, ku kërkoi nga ta që të votojnë që kjo pikë të kalojë për mbledhje të kuvendit.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikës së katërt të rendit të ditës, nëse jo atëherë konstatoj se pika katërt kalon për mbledhje të kuvendit. kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pëlqimit për këmbim të pronës publike komunale P – 04381-0.

Afrim Oruqi - Po ashtu drejtori prezantoi para anëtarëve të KPF-së pikën e pestë të rendit të ditës, ku kërkoi nga ta që të votojnë që kjo pikë të kalojë për mbledhje të kuvendit.

Kryesuesi - A ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikës së pestë të rendit të ditës, nëse jo atëherë konstatoj se pika pestë kalon për mbledhje të kuvendit. kalojmë në pikën e radhës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatshkurtër.

Afrim Oruqi - Po ashtu drejtori prezantoi para anëtarëve të KPF-së edhe pikën e gjashtë të rendit të ditës, ku kërkoi nga ta që të votojnë që kjo pikë të kalojë për mbledhje të kuvendit.

Fehmi Cena – Të nderuar jam pro kësaj pike, por kishte me qenë mirë që kjo parcelë të jepet për atë që është e destinuar, e jo të merret dhe pastaj të shfrytëzohet për komplet diçka tjetër.

Kryesuesi - A ka dikush të shtoj edhe diçka sa i përket pikës së gjashtë të rendit të ditës, nëse jo atëherë konstatoj se pika gjashtë kalon për mbledhje të kuvendit. kalojmë në pikën e radhës:

7. Raport nga DKA-ja rreth përfundimit të vitit mësimor 2019/2020.

Avni Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar anëtar të KPF-së po ju prezantoj raportin e DKA-së rreth përfundimit të vitit mësimor 2019/2020. Drejtoria Komunale e Arsimit e filloi vitin shkollor 2019-2020 sipas kalendarit të paraparë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH). Viti shkollor, ndonëse filloi mirë dhe me sukses u përmbyll gjysmëvjetori i parë, në gjysmëvjetorin e dytë, përkatësisht nga 12 marsi i këtij viti, për shkak të shfaqjes së pandemisë, me rekomandim të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, shkollat e të gjitha niveleve e poashtu edhe çerdhja, u mbyllën për nxënësit, fëmijët dhe personelin arsimor.

Ky vit shkollor vazhdoi megjithatë, por në rrethana të reja të krijuara, ne në DKA gjetëm forma të reja të organizimit dhe menjëherë filluam procesin e mbajtjes së mësimi nga distanca (mësimi online). Ndërkohë që përfundoi viti mësimor, gjegjësisht gjysmë vjetori i dytë i vitit mësimor, mund të themi se ishte një vit mësimor i vështirë për DKA-në, mësimdhënësit dhe veçanërisht me pasojë për nxënësit. Mund të themi se ishte viti më i vështirë, që nga paslufta.

Përkundër të gjitha zhvillimeve dhe vështirësive që na përçollën gjatë vitit mësimor, DKA u angazhua maksimalisht që gjatë periudhës kur u mbajt procesi mësimor i rregullt, por edhe ai online, të kemi mbarëvajtje.

Gjatë periudhës së pandemisë numri i nxënësve që nuk kanë mundur të përfshihen në mësimin online, nga niveli 0 deri tek klasa e 12 në të gjithë komunën është 1674 ose e shprehur në përqindje 17.6% e numrit të përgjithshëm. Sipas të dhënave që kemi marrë nga shkollat, numri i mësimdhënësve që për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të realizojnë mësimin nga distanca është 63 ose 8.45 %. Arsyet e mos përfshirjes janë të ndryshme, por kryesisht është mungesa e teknologjisë së nevojshme informative tek nxënësit, por edhe tek mësimdhënësit.

Gjatë vitit mësimor, sidomos në 3 mujorin e fundit, për shkak të pandemisë, edhe pse i patëm planifikuar, nuk arritëm të mbajmë gara të diturisë e gjithashtu na munguan edhe aktivitetet sportive e kulturore. E vetmja garë që u mbajt me sukses ishte gara e Olimpiadës Matematike në nivel shkollor, komunal dhe pastaj edhe në nivel republikan. Patëm edhe disa aktivitete për nder të festës së Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt dhe një manifestim kulturor dhe artistik për nder të festës së 7 marsit – Ditës së Mësuesit.

Gjatë pandemisë, më së keqi e pësuan nxënësit e klasave të para, semimaturantët dhe maturantët, për arsye se sivjet mungoi Festa e Abetares por edhe festat tjera të fundëvitit mësimor.

Edhe këtë vit mësimor kemi vazhduar me traditën e ndarjes së bursave për studentët e komunës sonë dhe këtë vit është rritur numri i përfituesve të bursave nga 95 studentë përfitues të bursës që ishte vitin e kaluar, në 100 studentë përfitues të bursës, që do të ndahen këtë vit .

DKA edhe këtë vit po vazhdon me realizimin e projekteve të saj, siç janë projektet për ndërtimin e objekteve shkollore, për ndërtimin e çerdheve, projekteve për ngrohje qendrore, ku përveç 3 objekteve shkollore që i përfunduam vitin që shkoi, këtë vit do t'i pajisim edhe dy objekte shkollore me ngrohje qendrore. Kemi nisur procedurat edhe për projektet e renovimit të nyjeve sanitare të shkollave, ndërkohë që

pasi përfunduar projektin e efijencës së energjisë në Shfmu “ Vëllezërit Frashëri” në Drenoc, ka filluar të realizohet projekti i efijencës së energjisë në Shfmu “ Nesimi Elshani” në Nagavc.

Me rekomandim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, këtë vit u shtyen Testi i Arritshmërisë për nxënësit e klasave të 9 –a dhe Testi i Maturës për nxënësit e klasave të 12-a. Këto dy teste do të mbahen në muajin gusht, përkatësisht më 20 dhe 29 gusht, 2020.

Ndërkohë, ka mbaruar edhe afati i parë i regjistrimit të nxënësve në klasat parashkollore dhe në klasat e para, por në klasat e 10-ta ky proces është shtyrë për shkak të pandemisë COVID-19.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar sa është numri i nxënësve të regjistruar për vitin e ri shkollor në klasat e para dhe atë parashkollor, a keni ndonjë shifër.

Avni Morina – E nderuar nuk kemi ndonjë shifër deri më tani, sepse nxënësit më shumë regjistrohen në afatin e dytë se sa në afatin e parë nuk e dimë pse ndodh kjo por ky është realiteti, por një gjë e dimë që ka rritje të numri të nxënësve.

Kryesuesi – Ju faleminderit të nderuar/a, konstatoj se edhe pika e shtatë kalon për mbledhje të kuvendit. kalojmë në pikën e radhës:

8. Informatë nga DSHPS-ja, për periudhën gjashtë mujore janar – qershor -2020.

Samir Mustafa – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar ju para vete e keni raportin e DSHPS-së, nëse keni diçka për të më pyetur jam këtu për të ju përgjigjur.

Fehmi Cena – I nderuari drejtor ky raporte është mirë i përpiluar, por sa jam duke parë është më shumë i fokusuar rreth menaxhimit të gjendjes së pandemisë se sa rreth problemeve të kësaj drejtorie sa i përket stafit dhe gjërave të tjera, poashtu në këtë raport duhet të përfshihen edhe punëtorët shëndetësorë sa i përket angazhimit të tyre në luftimin e kësaj pandemie.

Kryesuesi – Ju faleminderit, nëse nuk askush të shtoj edhe diçka sa i përket kësaj pike, mundemi të konstatojmë se edhe pika e tetë kalon për mbledhje të kuvendit.

9. Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar anëtarë të KPF-së ne duke e respektuar rekomandimet dhe planin e aprovuar, si komunë e Rahovecit kemi kontraktuar tre operator ekonomik që kanë kontratë me komunën e Rahovecit për mirëmbajtjen e hapësirave publike, po ashtu jemi në koordinim me drejtorin për urbanizëm pasi ajo merret me gjelbërimin e hapësirave publike, për më shumë fjala është e juaja.

Kryesuesi – A ka dikush të shtojë diçka sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë mundem të konstatoj se edhe pika nëntë kalon për mbledhje të kuvendit. kalojmë në pikën e radhës:

10. Informatë nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

Artan Asllani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar anëtarë të KPF-së Pas marrjes së vendimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës për themelimin e zonës ekonomike-park industrial K.K. Rahovec konkretisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-159 për zonat ekonomike, ka parashtruar kërkesa për pajisjen me pëlqime nga Ministritë e linjës dhe institucionet tjera për licencim të zonës ekonomike-parkut industrial. Pas kompletimit të të gjitha dokumenteve, pëlqimeve dhe projekteve, K.K. Rahovec e ka parashtruar kërkesën për licencim të Zonës Ekonomike-Parkut industrial në Ministrin për Tregti dhe Industri, kërkesa me nr. 235 të datës 22.01.2020, pas shqyrtimit të lëndës dhe kërkesës nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Ministri i Tregtisë dhe Industrisë Z. Endrit Shala me Vendimin 01.Nr.Prot.410 të datës: 27.01.2020 jep Pëlqimin për themelimin e Zonës Ekonomike, respektivisht Parkut Industrial në fshatin Opterushë. Pas themelimit dhe licencimit të zonës ekonomike-parkut industrial K.K. Rahovecit ka parashtruar kërkesë në Ministrin për Tregti dhe Industri-MTI për mbështetje financiare për funksionalizimin e zonës ekonomike-parkut industrial por që nuk është miratuar deri më tani. Komuna e Rahovecit në vitin 2018 ka investuar në rrafshimin dhe nivelizimin e një pjesë të zonës ekonomike në vlerë prej 4,360.00 €, ndërsa në vitin 2019 komuna e Rahovecit ka investuar në vlerë prej 68,460.00 €, investimet janë kryer në rrafshimin dhe rrethimin e një pjesë të zonës ekonomike - parkut industrial.

Gjatë vitit 2020 do të hartohet projekti kryesor për zonën ekonomike-parkut industrial, për vitin 2020 presim mbështetjen financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Kryesuesi – Ju faleminderit drejtor, a ka dikush të shtojë diçka sa i përket pikës së dhjetë të rendit të ditës, nëse jo atëherë edhe për pikën e dhjetë konstatoj se kalon për mbledhje të kuvendit. kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

11. Të ndryshme.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj diçka në pikën e fundit në të ndryshme, atëherë pasi që nuk ka diçka sa i përket pikës në të ndryshme, unë do të ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, po ashtu ju informoj se mbledhjen e rregullt të Kuvendit e planifikojmë me datën 29 të këtij muaji (e mërkurë), shihemi në mbledhjen e kuvendit.

Mbledhja përfundoj 11:50

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

